



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1182/prot
1

Tiranë , më 04.5. 2023

VENDIM

Nr. 21 , Datë 04.05 2023

“PËR

MIRATIMIN PARAPRAK TË PAGAVE TË PERSONELIT AKADEMIK SIPAS VENDORIT NR. 243, DATË 20.04.2023, PËR NJË NDRYSHIM NË VENDORIN NR. 748, DATË 11.6.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT AKADEMIK TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË”, TË NDRYSHUAR”

Referuar Ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika h, neni 49; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit nr.84 / 2022, “Për buxhetin e vitit 2023”; VKM-së Nr.75, datë 12.02.2018, “ Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, e ndryshuar; VKM-së nr. 243, datë 20.04.2023, “Për një ndryshim në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, pika 2/b; Udhëzimit të përbashkët Nr. 20, datë 20.09.2019, të MASR dhe MFE, “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 04.05.2023,

VENDOSI:

1. Miratimin paraparak të pagave të personelit akademik në kufirin maksimal të tyre, sipas Lidhjes nr.1- Strukturat dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, të VKM-së nr. 243, datë 20.04.2023.
2. Burimi i financimit mbi kufirin minimal dhe deri në kufirin maksimal, të përballohet me të ardhurat e universitetit.
3. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar.
4. Efektet financiare fillojnë nga data 1 Prill 2023.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

PROF.DR.ARTAN HOXHA